



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2021:097446

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05490461

P.nr.1277/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.B., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrin ndëshkimor me numër PP.II.nr.1857/21, të datës 17.05.2021, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datë 22.03.2024 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit, PP.II.nr.1857/21, të datës 17.05.2021, andaj Gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPP-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari: M.B., nga i ati K, i lindur me datë ....., në ....., me vendbanim në Rr. “....“, ....., p/n, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 24.02.2021, rreth orës 15:05, në rrugën “Mon Balaj“ në Prishtinë, saktësisht në magjistralen Prishtinë-Podujevë, gjatë kontrollit të policisë, tek i akuzuari M.B. është gjetur një cigare dhe një qese e vogël e substancës, të cilat dyshohej të ishin substanca narkotike, të cilat substanca pas ekzaminimit ka rezultuar të jenë Kanabis (marihuanë) që përmban

Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme  $1.15 \pm 0.0001$  gram, të cilat i akuzuari i ka poseduar pa autorizim.

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPP-së të akuzuarit të lartcekur i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

I. Në shumën prej 400€ (katërqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës, do t'i caktohet 1 (një) ditë burgim.

III. Në mbështetje të nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së, URDHËROHET KONFISKIMI i përhershëm i:

- Substancës narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 1.15gram. Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit kjo sasi e narkotikëve duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

IV. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro), si dhe shumën prej 20€ (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1857/21, të datës 17.05.2021, kundër të akuzuarit M.B., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së dhe njëherit ka propozuar që ndaj të njëjtit të jepet Urdhër Ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme, që vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës, së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se në këtë çështje penalo-juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPP-së për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe konform nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë, dhe deri tek një konstatim i tillë Gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali i marrjes në pyetje i M.B. të datës 24.02.2021, raporti i testit labarotorik i datës 01.04.2021, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nr.2021-AC-0242, Urdhëresa PP.II.nr.1857/21 e dt. 17.05.2021, si dhe shkresat e tjera të bashkangjitura në lëndë dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat, Gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm dhe të përhershëm të substancës narkotike të llojit ‘‘Kanabis (Marihuanë)’’, me peshë prej 1.15 \gram, e sekuestruar nga i akuzuari. Gjykata, ka vërtetuar se i akuzuari nuk posedonte leje, e as autorizim për posedimin e narkotikëve, e për më tepër substanca narkotike e lartcekur bën pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike, andaj Gjykata ka vendosur të konfiskoj përherë këtë sasi të narkotikëve si dhe ka urdhëruar shkatërrimin e saj, pasi që ekziston baza ligjore për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike, ashtu siç përcaktohet me nenin 276 të KPP-së dhe nenin 269 par.3 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u morr konform nenit 449 par.1 dhe 2, pika 2.6 të KPP-së, ndërkaq vendimi për shumën e të hollave në

emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Nga sa u tha më lart, në bazë të neneve 364 dhe 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1277/2021, me datë 22.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Dibran Jusufi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të tij. Kundërshtimi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të Gjykatës.